

KREU VI
PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE
ME DIPLOMË TË HUAJ TË SHKOLLËS SË MESME, NË PROGRAMET E
STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, NË PROGRAMET E CIKLIT TË
PARË TË STUDIMEVE SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË
STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

1. Të gjithë kandidatët me diplomë të huaj të arsimit të mesëm të lartë, që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në IAL, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, sipas afateve të përcaktuara nga IAL-të, për çdo vit akademik, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat për këto kategori nga IAL-të në programet e studimit që ato ofrojnë.
2. Kandidatët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe të jenë të pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor, nuk duhet të rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara nga IAL-të, për programet e studimit për të cilët aplikojnë.
3. Kandidatët, i nënshtrohen procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, sipas afateve të përcaktuara në këtë kre. Regjistrimi i këtyre kandidatëve fitues bëhet me rezervë, nëse në momentin e regjistrimit nuk zotërojnë dokumentin e njohjes dhe njehsimit të lëshuar nga QSHA.
4. Kandidatët, përpara aplikimit kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të IAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të IAL-së pranë të cilit aplikojnë.
5. Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa IAL.
6. Kandidatët duhet të paraqesin pranë IAL-ve dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 2, të këtij udhëzimi;
 - b) kopje të dokumentit të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore që vërteton njohjen e diplomës së arsimit të mesëm të lartë, shoqëruar me kopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave. Kandidatët që nuk e kanë përfunduar procesin e njohjes dhe njehsimit paraqesin vërtetimin që kanë aplikuar pranë QSHA për njohje dhe njehsim;
 - c) kopjen e dokumentit të identifikimit;
 - d) dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga strukturat përgjegjëse (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhen shqipe). Kandidatët që kanë kombësi shqiptare dhe njohuri të gjuhës shqipe, mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë;
 - e) dy fotografi personale;
 - f) kopjen e mandatpagesës;
 - g) deklaratën sipas shtojcës nr. 1, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi.

**AFATET E APLIKIMIT DHE REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E
CIKLIT TË PARË TË STUDIMIT**

KATEGORIA E STUDENTËVE ME DIPLOMË TË HUAJ.

VITI AKADEMIK 2025-2026.

Referenca në Udhëzim	Afatet e përfundimit dhe data e realizimit
Aplikim	01. 09. 2025 — 13. 09. 2025
Publikimi i listave jo përfundimtare të fituesve	18. 09. 2025
Shpallja e listave përfundimtare të kandidatëve fitues	22. 09. 2025
Regjistrimi i kandidatit	23. 09. 2025-29. 09. 2025
Plotësimi i kuotave të mbetura bosh (ulja evijës)	30. 09. 2025
Përfundimi i regjistrimeve të të gjithë kandidatëve fitues sipas dokumentave të dorëzuar në momentin e aplikimit.	27. 10. 2025